



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J


Mbledhjen e parë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më 23.01.2020 (e enjte) duke filluar ne ora 10:00.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Raporti i Kryesuesit për punën e Kuvendit për vitin kalendarik 2019;
3. Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të KPF-së për vitin 2020;
4. Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal për vitin 2020;
5. Të ndryshme.


Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:16.01.2020
Në: Novobërdë



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic

Nebojsa Arsic



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dymbëdhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 16.12.2019, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesusi i Kuvendit Nebojsa Arsic, Anëtarët e KPF-së: Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Xhejlane Behluli, Selatin Nuhiu, Drejtori i Financave Sercan Todorovic.

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: Para se të fillojmë me rendin e ditës duhet konstatuar kuorumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

R e n d d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;
2. Shqyrtimi i Raportit Financiar për tremujorin e tretë Korrik-Shtator 2019;
3. Të ndryshme.

Kryesusi tha: a keni ndonjë propozim apo pajtoheni me këtë rend dite?.

Pasi nuk pati propozime aprovohet njëzëri rendi i ditës.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-se;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje procesverbali aprovohet njëzëri nga antarët e KPF-së.

Pika e dytë: Shqyrtimi i Raportit Financiar për tremujorin e tretë Korrik-Shtator 2019;

Kryesusi për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Financave Sercan Todorovic;

Sercan Todorovic pasi pershendeti të pranishmit tha: fillimisht ju kerkoj falje që nuk e keni marr materialin me kohë po kemi pasur disa probleme teknike si dhe është vonuar në përkthim pasi që kemi mbetur vetem me një përkthyes, kerkoj që ta votoni këtë pikë ta dergoni në Kuvend e pastaj do të diskutojm si dhe do të keni kohë që ta analizoni. Po e bëjë një prezantim të shkurtër të hyrat për këtë tremujor kanë qenë 40,435.43€ i keni në raport të hyrat prej të gjitha taksave, për paga dhe meditje kan qenë të planifikuara shuma prej 475,868.25€ janë shpenzuar në shumë 475,630.94 €, për mallra dhe sherbime janë shpenzuar mjetet në shumë prej 54,445.23 €, për shpenzimet Komunale janë shpenzuar mjetet në shumë prej 13,406.03 €, për subvencione janë shpenzuar mjetet në shumë prej 14,915.00€, për investime kapitale janë shpenzuar mjetet në shumë prej 87,213.87 €. Kaq kisha nese keni ndonjë pyetje udhëroni, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: raporti është me vones, është duhur të jetë këtu para dy muajve, është bërë praktike kjo që raportet zyrtarët Komunal nuk i bien me kohë, pak sa mujta me analizu të hyrat nga participimi në shendetësi 40,435.43€ kjo rubrik besoj se duhet me qenë totali, por ta dergojm këtë pikë në Kuvend dhe deri atëher do të kemi më shumë kohë që ta analizojmë.

Sercan Todorovic tha: është gabim gjatë përkthimit pasi që në gjuhen serbe është mirë.

Pasi nuk pat diskutime tjera aprovohet me 4 vota pwr dhe 1 kunder (Milica Jovanovic) kjo pikë që të shkoj në Kuvend.

Pika e tretë: Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në orën 10:20.

Procesëmbajtëse
Valmire Mustafa



Kryesues i Kuvendit
Nebojsa Arsic






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
z.Nebojsa Arsic



RAPORT I KRYESUESIT PËR PUNËN E KUVENDIT PËR VITIN KALENDARIK
2019

Janar 2020

Të respektuar/a

Anëtarë/e të Kuvendit Komunal të Novobërdës.

Ju drejtohem si Kryesues i Kuvendit të ju raportoj për punën një-vjeçare të Kuvendit Komunal të Novobërdës, duke i përmbledhur rezultatet në çdo fushë, kështu edhe Kryesuesi i Kuvendit ka obligim që për punën vetë dhe të Kuvendit ti njoftoj ata me të cilët së bashku punon për të përmisuar kualitetin e punës, si dhe të gjithë atyre që janë të lidhur me Kuvendin pa të cilët nuk mundet të punoj dhe realizoj qëllimet e veta: Kryetarin, Drejtorët, Ministrit kompetente e në fund edhe ata që janë më të rëndësishmit e na kanë dhënë besimin, që t'i prezentojmë në këtë organ, e ata janë qytetarët e Komunës sonë. Gjithashtu kam knaqësinë që jamë në krye të një Kuvendi multietnik, për të cilën mundë lirishtë të them që paraqet një shembull të mire të bashkpunimit në mesë të Këshilltarëve të Komuniteteve të ndryshme ku në planin e pare është bashkëpunimi në mesë të anëtarëve të komuniteteve të ndryshme dhe kanë për qëllim realizimin e kushteve më të mira të jetës për qytetarët e vetë.

Siç është e ditur Kuvendi Komunal mbështetet në aktet juridike, duke filluar nga Ligji për Vetqeverisjen Lokale, si aktin më të lartë e përmes statutit si aktin më të rëndësishëm të Kuvendit, rregullores së Kuvendit dhe akteve tjera që i aprovon Komuna. Në këtë drejtim në bazë të nenit 43.2, Ligjit për Vetqeverisje Lokale, si dhe nenit 43.2 të statutit, Kuvendi i Komunës është e obliguar t'i mbajë dhjetë mbledhje të rregullta gjatë vitit, edhe atë pesë në pjesën e pare të vitit dhe pesë në pjesën e dyte. Me knaqësi mundë të konstatoj se kemi vepruar në bazë te nenit 43.2 LVL, si dhe nenit 43.2 të statutit në kuptimin e përmbajtjes së afateve për mbajtjen e mbledhjeve.

Kuvendi Komunal ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta dhe një të jashtëzakonshme. Të gjitha mbledhjet janë mbajtur në bazë të planit vjetor të punës.

Në mbledhjet e rregullta dhe jashtëzakonshme të mbajtura kemi aprovuar:

1. 17 vendime, dhe të gjitha janë verifikuar nga ana e Ministrisë kompetente për vetqeverisje lokale.

Kuvendi përveq mbledhjeve të rregullta të Kuvendit kemi mbajtur edhe mbledhje të rregullta të Komitetit për Politik dhe Financa ku për këtë viti i kemi mbajtu 12 mbledhje që do të thotë se para çdo mbledhje të Kuvendit kemi shtejlluar njëher pikat në KPF-ë.


Gjatë këtij viti është formuar një komision nga Kuvendi Komunal: komisioni për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale.

Të nderuar antarë të Kuvendit në fundë të këtij raporti deshiroj t'ju falenderohem për bashkpunimin dhe kontributin e juaj në punën e Kuvendit. Çdo propozim u juaji është i mirëseardhur, shpresoj që në këtë vit të kemi më shumë bashkpunim me Këshillin Egzekutiv dhe me angazhimin tone, me sjellje të mirfilltë mundemi të realizojmë rezultate më të mira në Kuvendë ku e gjithë kjo do të reflektohet në përmisimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët, dhe shërbimet tjera si dhe ngritja e nivelit të infrastruktures Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së
Novobërdës




Nebojsa Arsic



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

DATË/A:	09.01.2020
PËR/ZA/TO:	Antarët e KPF-së
NGA/OD/FROM:	Nebojsa Arsic – Kryesues i Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të KPF-së për vitin 2020

Të nderuar,

Në bazë të nenit 43.6 të Statutit po ju dërgoj orarin e mbajtjes së mbledhjeve të Komitetit për Politik dhe Financa për vitin 2020

Nr	Dita	Data	Koha	Vendi
1.	E enjte	23.01.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
2.	E marte	18.02.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
3.	E hënë	23.03.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
4.	E martë	22.04.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
5.	E hënë	18.05.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
6.	E hënë	22.06.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
7.	E martë	21.07.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
8.	E enjte	27.08.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
9.	E martë	22.09.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
10.	E hënë	19.10.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
11.	E martë	17.11.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
12.	E martë	22.11.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

DATE/A:	09.01.2020
PËR/ZA/TO:	Antarët e Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	Nebojsa Arsic – Kryesues i Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozimi i orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal për vitin 2020

Të nderuar,

Në bazë të nenit 43.6 të Statutit po ju dërgoj orarin e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2020.

Nr	Dita	Data	Koha	Vendi
1.	E enjte	30.01.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
2.	E enjte	27.02.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
3.	E martë	31.03.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
4.	E enjte	30.04.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
5.	E enjte	27.05.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
6.	E martë	30.06.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
7.	E enjte	30.07.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
8.	E hënë	07.09.2019	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
9.	E mërkur	30.09.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
10.	E enjte	29.10.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
11.	E enjte	26.11.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal
12.	E mërkur	29.12.2020	10:00	Salla e Kuvendit Komunal